

L I G J
Nr.8151, datë 12.9.1996

**PËR NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7573 DATË 16.6.1992 “PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE
TË PUSHTETIT LOKAL”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si vijon:

"Kanë të drejtën e votës shtetasit shqiptarë që ditën e zgjedhjeve kanë mbushur moshën 18 vjeç, me përjashtim të personave, të cilëve u është hequr me vendim të gjykatës zotësia për të vepruar.

Si rregull, e drejta e votës ushtrohet në territorin e komunës, të bashkisë ose të rrethit ku zgjedhësi ka vendbanimin e tij."

Neni 2

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Kanë të drejtë të zgjidhen anëtarë të këshillave lokale ose kryetarë komune a bashkie shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës.

Përfshihen nga kjo e drejtë shtetasit që janë të arrestuar ose që janë duke vuajtur dënimin me burg.

Për t'u zgjedhur kryetar bashkie duhet të përmbushen edhe kërkesat e ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995 “Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit, kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike e fetare”, si dhe të ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995 “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”".

Neni 3

Neni 4 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Pjesëtarët e forcave të armatosura, gjyqtarët dhe prokurorët, në rast se paraqesin kandidaturën për t'u zgjedhur në pushtetin lokal, duhet të japin dorëheqjen dhe të largohen nga detyra."

Neni 5

Në nenin 7 fjalët “të paktën 35 ditë”, bëhen “të paktën 45 ditë”.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"Listat e zgjedhësve hartohen për çdo qendër votimi.

Në listat e zgjedhësve shënohen emri, atësia dhe mbiemri i votuesit, datëlindja e tij dhe numri i regjistrimit.

Listat e zgjedhësve hartohen nën përgjegjësinë e kryetarit të bashkisë a komunës dhe të

sekretarit të këshillit përkatës. Listat e zgjedhësve, pasi nënshkruhen nga personat e mësipërm, i dërgohen prefekturës përkatëse. Prefekti bën konfirmimin e tyre dhe, sipas rastit, zgjidh mosmarrevëshjet në lidhje me to. Ai detyrohet që jo më vonë se 2 ditë pas shpalljes së listave të zgjedhësve të sjellë në Sekretariat Shtetëror të Pushtetit Lokal numrin e zgjedhësve për çdo zonë zgjedhjeje.

Listat e zgjedhësve qëndrojnë në mënyrë të përhershme pranë zyrës së gjendjes civile.

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për hartimin e saktë e në kohë të listave, si dhe për mënyrën e ruajtjes e të administrimit të tyre."

Neni 7

Në nenin 12 fjalët "jo më vonë se 15 ditë", bëhen "jo më vonë se 17 ditë".

Neni 8

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. "jo më vonë se 15 ditë", bëhet "jo më vonë se 17 ditë".
2. Fjalët "organet ekzekutive të pushtetit lokal më të afërt, në bashkëpunim me komandat e njësisve dhe të reparteve ushtarake", zëvendësohen me fjalët "organet e përcaktuara në nenin 10, në territorin e të cilave ndodhet njësi ose reparti ushtarak, në bashkëpunim me komandat e tyre".

Neni 9

Neni 21 ndryshohet si vijon:

"Qendrat e votimit caktohen jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Ato krijohen me vendim të organeve që shpallin listat e zgjedhësve, në përputhje me rregullat procedurale që ndiqen për shpalljen e listave të zgjedhësve."

Neni 10

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve funksionojnë:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- b) komisionet e zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve;
- c) komisionet e qendrave të votimit.

Komisionet e zgjedhjeve janë organizma të pavarur që në veprimtarinë e tyre i nënshtrohen vetëm ligjit. Veprimtaria e ushtruar prej anëtarëve të komisioneve është veprimtari shtetërore dhe jo politike. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre anëtarët e komisioneve gëzojnë imunitet. Partitë politike, në përputhje me rregullat e vendosura nga ky ligj, kanë të drejtë të kërkojnë zëvendësimin e përfaqësuesve të tyre në komisionet e zgjedhjeve, por ato nuk gëzojnë të drejtën që të urdhërojnë largimin e tyre nga komisionet.

Sekretarët e komisioneve të zgjedhjeve të rretheve duhet të jenë juristë."

Neni 11

Neni 24 ndryshohet si vijon:

"Në çdo zonë zgjedhjeje (komunë, bashki, rreth) ngrihet komisioni i zgjedhjeve të zonës, i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe nga një përfaqësues për çdo subjekt ose grupim elektorale që ka kandidat në atë zonë, si dhe nga një person pa parti, kur numri i anëtarëve të komisionit është çift. Sekretari dhe personi pa parti caktohen nga prefekti. Kryetari dhe zëvendëskryetari i komisionit të zgjedhjeve të rrethit caktohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kryetari është përfaqësuesi i Qeverisë. Zëvendëskryetari caktohet nga partia, e cila, ndër partitë politike që nuk bëjnë pjesë në koalicionin qeveritar, ka përfaqësimin më të lartë në organin përkatës të pushtetit lokal. Në rast se kjo parti nuk paraqet kandidaturë për zëvendëskryetar, atëherë ky vend i jepet partisë vijuese opozitare.

Propozimet për anëtarët e komisionit të zgjedhjeve të rrethit dërgohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jo më vonë se 30 ditë para ditës së zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton përbërjen e komisionit të zgjedhjeve të rrethit jo më vonë se 28 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve të zgjedhjeve të komunave dhe bashkive caktohen nga kryesitë e komisioneve të zgjedhjeve të rretheve përkatëse, sipas rregullit të përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni. Propozimet për anëtarët e këtyre komisioneve bëhen jo më vonë se 25 ditë para ditës së zgjedhjeve. Miratimi dhe shpallja e përbërjes së tyre bëhet jo më vonë se 23 ditë para ditës së zgjedhjeve nga komisionet e zgjedhjeve të rretheve."

Neni 12

Neni 25 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i zgjedhjeve i zonës kryen këto detyra:

a) Kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëjlojtë të këtij ligji gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e zonës;

b) ushtron kontroll mbi veprimtarinë e komisioneve të qendrave të votimit gjatë zhvillimit të zgjedhjeve; komisioni i zgjedhjeve i rrethit kontrollon edhe veprimtarinë e komisioneve të zgjedhjeve të komunave e të bashkive përkatëse;

c) mbikëqyr formimin sipas ligjit të qendrave të votimit;

ç) regjistron dhe shpall kandidatët dhe listat shumemërore të subjekteve elektorale, si dhe kandidatët e pavarur për organet përkatëse të pushtetit lokal;

d) sipas rastit i kërkon organeve që kanë shpallur listat e zgjedhësve, që të bëjnë rregullimin e gabimeve e të mangësive të vërejtura në to;

dh) në përputhje me rregullat e vendosura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, komisioni i zgjedhjeve i komunës ose i bashkisë lëshon autorizime për vëzhguesit e subjekteve elektorale në qendrat e votimit, kurse komisioni i zgjedhjeve i rrethit lëshon autorizime për vëzhguesit e subjekteve elektorale në komisionet e komunave ose të bashkive;

e) numëron votat në mbështetje të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe shpall përfundimet e zgjedhjeve në zonë. Mbi bazën e këtyre përfundimeve, komisioni i zgjedhjeve i komunës a i bashkisë i lëshon vërtetimin e zgjedhjes kryetarit të ri të zgjedhur, si dhe këshilltarëve të komunave a bashkive. Komisioni i zgjedhjeve i rrethit u lëshon vërtetimin e zgjedhjes këshilltarëve të rrethit;

ë) shqyrton ankimet kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme ose të parregullta të komisioneve të qendrave të votimit; komisioni i zgjedhjeve i rrethit shqyrton dhe ankimet ndaj akteve dhe vendimeve të komisioneve të komunave e bashkive;

f) organizon votimin e raundit të dytë, kur del e nevojshme;

g) komisioni i zgjedhjeve i komunës ose i bashkisë i dorëzon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe komisionit të zgjedhjeve të rrethit aktet e zgjedhjeve që përmenden në këtë ligj; komisioni i zgjedhjeve i rrethit aktet e tij të zgjedhjeve i dorëzon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;

gj) komisionet e zgjedhjeve të komunave dhe bashkive lëshojnë certifikata për të drejtë vote për rastet e përcaktuara në këtë ligj."

Neni 13

Neni 26 ndryshohet si vijon:

"Në çdo qendër votimi ngrihet komisioni i qendrës së votimit i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe një përfaqësues për çdo subjekt ose grupim elektoral që ka paraqitur kandidatë në komunë ose bashki, si dhe një person pa parti, kur numri i anëtarëve të komisionit është çift. Sekretari dhe personi pa parti caktohen nga prefekti, kurse kryetari dhe zëvendëskryetari caktohen nga kryesia e komisionit të zgjedhjeve të komunës ose bashkisë, sipas rregullit të përcaktuar për komisionet e komunave dhe të bashkive.

Propozimet për anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dërgohen në komisionin e zgjedhjeve të komunës ose të bashkisë jo më vonë se 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. Kryesia e komisionit të zgjedhjeve të komunës ose bashkisë shpall përbërjen e komisionit të qendrës së votimit

jo më vonë se 10 ditë para ditës së zgjedhjeve."

Neni 14

Neni 27 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i qendrës së votimit kryen këto detyra:

- a) Siguron zhvillimin e lirë dhe të qetë të zgjedhjeve në qendrën e votimit në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë ligj;
- b) kujdeset për zbatimin me përpikëri të procedurave të votimit;
- c) regjistron zgjedhësit që paraqiten për të votuar me certifikatë për të drejtë vote dhe ata që paraqiten me vendim të gjykatës;
- d) numëron votat e hedhura për çdo kandidat e listë shumemërore;
- dh) përgatit dhe i dorëzon komisionit të zgjedhjeve të komunës ose të bashkisë procesverbalet e votimit të përcaktuara në këtë ligj;
- e) mban procesverbal për ankesat dhe kërkesat e anëtarëve të komisionit e të zgjedhësve, i shqyrton ato dhe merr vendimin përkatës."

Neni 15

Në nenin 37 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Personat, që ndaj anëtarëve të komisioneve të zgjedhjeve, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, kryejnë një nga veprat penale të përcaktuara në dispozitat e Kodit Penal, që përfshihen në kreun e krimeve kundër autoritetit të shtetit, dënohen me heqje lirie, në masën e caktuar prej këtyre dispozitave.

Personat që bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve, mbajnë përgjegjësi ligjore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji."

Neni 16

Në paragrafin e parë të nenit 40 fjalët "Gjykatën e Kasacionit", zëvendësohen me fjalët "Gjykatën Kushtetuese".

Në paragrafin e dytë të nenit 40 fjalët "Gjykata e Kasacionit", zëvendësohen me fjalët "Gjykata Kushtetuese".

Neni 17

Në nenin 42 shtohen këta paragrafë:

"Fushata elektorale në Radiotelevizionin Shtetëror bëhet në emisione të posaçme. Partive, të cilat në zgjedhjet e fundit për këshillat e rretheve kanë fituar më shumë se 0,50 për qind të votave, u vihet në dispozicion një kohë e përgjithshme transmetimi prej 4 orësh, gjysma e së cilës u takon partive të koalicionit qeveritar dhe gjysma tjetër partive të opozitës. Kjo kohë ndahet midis tyre në përputhje me përqindjen e votave të fituara në ato zgjedhje, por jo më pak se 15 minuta për një subjekt. Të gjitha partive të tjera politike, që marrin pjesë në zgjedhje, u vihen në dispozicion nga 10 minuta.

Platforma dhe programi i transmetimeve elektorale, që do të vihen në dispozicion të partive politike për fushatën elektorale, miratohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Çdo kohë shtesë që Radiotelevizioni Shtetëror mund të verë në dispozicion për debatet elektorale ose për fushatën elektorale të partive, ndahet sipas raporteve të përcaktuara në paragrafin e mësipërm.

Për të mbikëqyrur zbatimin rigoroz të kohës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve krijon me anëtarët e tij një nënkomision me përfaqësues të pozitës dhe të opozitës, i cili e informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve çdo ditë për zbatimin e rregullave të përcaktuara më sipër. Në rast se këto rregulla nuk respektohen, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr të gjitha masat e nevojshme për garantimin e tyre."

Neni 18

Neni 49 ndryshohet si vijon:

"Këshilli i Ministrave cakton fonde nga buxheti për fushatën elektorale të partive politike.

Shuma e akorduar nga buxheti i shtetit për partitë politike, që marrin pjesë në zgjedhjet e pushtetit lokal, u jepet këtyre partive në përputhje me përqindjen e votave të fituara në zgjedhjet për këshillin e rrethit. Nuk përfitojnë nga ky rregull partitë politike që, në shkallë vendi, nuk arrijnë të fitojnë 2 për qind të votave për këshillin e rrethit.

Këshilli i Ministrave u cakton një shumë të hollash në formë paradhënie partive që në zgjedhjet e fundit të pushtetit lokal kanë fituar më shumë se 1 për qind të votave për këshillin e rrethit. Pas përfundimit të zgjedhjeve, kur partitë politike që kanë përfutur shumën e tillë nuk përmbushin kushtet e paragrafit të mësipërm, atëherë ato detyrohen të kthejnë shumën e dhënë në paradhënie ose pjesën e tepërta të këtyre shumave."

Neni 19

Në nenin 51 bëhen këto ndryshime:

Fjalët "Për Bashkinë e Tiranës 35 këshilltarë" bëhen "Për Bashkinë e Tiranës 45 këshilltarë".

Në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Numri i këshilltarëve për çdo komunë, bashki dhe rreth caktohet në përputhje me kriteret e përmendura më sipër nga Sekretariati Shtetëror i Pushtetit Lokal."

Neni 20

Në nenin 52 fjalët "jo më vonë se 15 ditë" bëhen "jo më vonë se 20 ditë".

Neni 21

Në nenin 53 pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"Për kryetarët e bashkive, kopja e vendimit të komisionit shtetëror të kontrollit të figurës së zyrtarëve."

Neni 22

Në nenin 55 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shkronja "ç" e nenit 53 zbatohet edhe për regjistrimin e kandidatëve të pavarur për kryetar bashkie."

Neni 23

Në nenin 59 fjalët "jo më vonë se 10 ditë" bëhen "jo më vonë se 17 ditë".

Në fund të këtij neni shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Komisionet e zgjedhjeve të komunave, bashkive dhe rretheve dërgojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kopje të shpalljes së kandidaturave, brenda dy ditëve nga data e shpalljes së tyre."

Neni 24

Neni 61 ndryshohet si vijon:

"Subjektet elektorale gëzojnë të drejtën për të bërë zëvendësimin e kandidatëve të propozuar prej tyre dhe për të bërë ndryshime në listat shumëmbrore që kanë paraqitur, deri 17 ditë para datës së zgjedhjeve. Pas kalimit të këtij afati nuk lejohet që të bëhen ndryshime në to. Në rast se njëri nga kandidatët për kryetar komune ose bashkie vdes pas kalimit të këtij afati, atëherë zgjedhjet për kryetar komune ose bashkie në këtë zonë zhvillohen jo më vonë se 9 javë pas datës së zgjedhjeve. Data e zhvillimit të këtyre zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës."

Neni 25

Neni 62 ndryshohet si vijon:

"Votimi kryhet sipas modeleve të fletëvotimeve që caktohen nga Këshilli i Ministrave. Fletëvotimet janë të njëjta në formë, madhësi, ngjyrë e përbërje të letrës. Komisioneve të zgjedhjeve të zonave, fletëvotimet u jepen në numër 15 për qind më të madh se numri i zgjedhësve të regjistruar në listat përkatëse të zgjedhësve në ditën e shpalljes së tyre."

Neni 26

Neni 63 ndryshohet si vijon:

"Për zgjedhjet e organeve përfaqësuese të komunave ose të bashkive përdoren dy fletëvotimi, njëra për kryetarin e komunës ose të bashkisë dhe tjetra për këshillin e komunës ose të bashkisë. Në fletëvotimin për kryetarin e komunës ose të bashkisë shënohen: sigla e subjektit, emri, atësia dhe mbiemri për çdo kandidat, emërtimi i subjektit të cilit i përkasin; për kandidatët e pavarur shkruhen fjalët "kandidat i pavarur".

Në fletëvotimin për këshillin e komunës ose të bashkisë shënohen siglat dhe emërtimet e subjekteve elektorale që kanë paraqitur lista shumemërore për këshillat përkatës. Në vazhdim shënohen emrat e kandidatëve të pavarur për këshilltar komune ose bashkie, sipas rendit alfabetik të tyre me emërtimin "kandidat i pavarur".

Fletëvotimi për këshillin e rrethit përmban siglën dhe emërtimin e subjektit elektoral, që ka paraqitur listë shumemërore për këshillin e rrethit dhe, në vazhdim, emrat e kandidatëve të pavarur për këshilltar rrethi me emërtimin "kandidat i pavarur".

Në çdo fletëvotimi renditja bëhet sipas rendit alfabetik të subjektit elektoral.

Në anën e majtë të fletëvotimit, në fillim të çdo rreshti me të dhënat e përmendura më sipër, ka një ndarje në të cilën zgjedhësi bën shënimin përkatës për kandidatin ose për subjektin elektoral, për të cilin voton. Në këtë ndarje zgjedhësi mund të vendosë shenjën matematikore të mbledhjes (+), të shumëzimit (X) ose të zbritjes (-)."

Neni 27

Neni 64 shfuqizohet.

Neni 28

Neni 66 ndryshohet si vijon:

"Votimi për zgjedhjen e organeve të pushtetit lokal bëhet në një ditë pushimi për gjithë vendin.

Votimi fillon në orën 0800 dhe mbyllet në orën 2100. Në qoftë se para orës 2100 ka ende njerëz që presin të votojnë, votimi vazhdon derisa të mbarojnë të gjithë të pranishmit.

Në ditën e votimit komisioni i qendrës së votimit e fillon punën në orën 700, duke bërë kontrollin e kutisë së votimit. Pas kësaj kutia mbyllet dhe vuloset me vulën e qendrës së votimit, e cila mbahet në ruajtje.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit, në prani të komisionit, vulos të gjitha fletët e votimit, numri i të cilave shënohet në procesverbalin që firmoset nga të gjithë anëtarët e pranishëm të komisionit.

Pas vulosjes, kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari, në prani të anëtarëve të komisionit, firmosin fletët e votimit.

Pas kryerjes sipas radhës të veprimeve të përmendura më sipër, kryetari i komisionit të qendrës së votimit deklaron fillimin e votimit."

Neni 29

Paragrafi 2 i nenit 67 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i qendrës së votimit është i detyruar të vërtetojë identitetin zgjedhësve që marrin pjesë në votim. Për vërtetimin e identitetit të tyre, ai ka të drejtë t'u kërkojë zgjedhësve që të paraqesin, sipas rastit, letërnjoftimin, pasaportën për jashtë shtetit, librezën ushtarake ose një certifikatë me fotografi."

Neni 30

Paragrafi 6 i nenit 68 ndryshohet si vijon:

"Në qoftë se është e nevojshme për të vendosur rregull në qendrën e votimit dhe për të siguruar zhvillimin e qetë e të lirë të votimit, kryesia e komisionit të qendrës së votimit, me vendim unanim, mund të kërkojë ndihmën e organeve të policisë, të cilat në këtë rast janë të detyruara të kryejnë vetëm ato veprime e të marrin vetëm ato masa që i kërkojnë. Në rast se nuk arrihet unanimiteti i kryesisë dhe nga komisioni çmohet se është e nevojshme ndihma e organeve të policisë, atëherë vendimi merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të komisionit."

Neni 31

Neni 69 ndryshohet si vijon:

"Gjatë kontrollit dhe numërimit të fletëve të votimit, sipas nenit 66 të këtij ligji, komisioni i qendrës së votimit, kur vëren se midis fletëve të votimit të marra në dorëzim ka fletë votimi, të cilat nuk i përgjigjen kërkesave për formën, madhësinë, ngjyrën, përbërjen e letrës dhe përmbajtjen, i nxjerr ato jashtë përdorimit, duke shënuar në secilën prej tyre fjalët "jashtë përdorimit".

Ky rregull zbatohet edhe për fletët e votimit që janë të grisura a të dëmtuara, ose që gjatë zhvillimit të procesit të votimit grisen apo dëmtohen, si dhe për fletët e votimit të plotësuara gabim.

Këto fletë votimi mbahen në ruajtje nga ana e komisionit dhe numri i tyre regjistrohet në procesverbalin përfundimtar.

Fletët e votimit të gjetura brenda në kuti pas përfundimit të votimit, kur nuk u përgjigjen kërkesave për formën, madhësinë, ngjyrën, përbërjen e letrës, përmbajtjen, si dhe kur nuk përmbajnë vulën dhe nënshkrimet sipas nenit 66, quhen fletëvotimi të parregullta. Numri i tyre shënohet në procesverbalin përfundimtar dhe këto fletëvotimi ruhen veçmas."

Neni 32

Neni 70 ndryshohet si vijon:

"Fletëvotimet e rregullta të gjetura brenda në kuti janë të vlefshme dhe llogariten si vota për kandidatët ose subjektet që marrin pjesë në zgjedhjet për organet përkatëse të pushtetit lokal, vetëm në qoftë se votuesit në fletët e votimit kanë vënë shenjë vetëm për njërin nga kandidatët ose subjektet elektorale të paraqitur në fletëvotimet përkatëse.

Në çdo rast tjetër fletëvotimet e rregullta quhen fletëvotimi të rregullta të pavlefshme. Fletët e votimit quhen të tilla edhe në rastet kur zgjedhësi, pavarësisht se ka vënë shenjë për njërin nga kandidatët ose subjektet, ka bërë shënime të tjera shtesë në të."

Neni 33

Shkronja "b" e neni 74 ndryshohet si vijon:

"bëhet numërimi i fletëve të votimit të gjetura brenda në kuti, numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të parregullta, numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të rregullta të pavlefshme dhe në fund numërohen fletët e votimit që janë vlerësuar të rregullta, të vlefshme për secilin nga kandidatët ose subjektet."

Neni 34

Neni 75 ndryshohet si vijon:

"Vlerësimi i votës bëhet nga komisioni i qendrës së votimit. Votat e diskutueshme fillimisht shqyrtohen dhe pastaj vlerësohen. Çdo kundërshtim nga anëtarët e komisionit shënohet në

procesverbal dhe këto fletëvotimi ruhen veçmas."

Neni 35

Neni 76 ndryshohet si vijon:

"Në përfundim të votimit, numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit, kryesia e komisionit të qendrës së votimit plotëson detyrimisht tri procesverbale: një për këshilltarët e komunës ose bashkisë, një për kryetarin e komunës ose bashkisë dhe një për këshilltarët e rrethit.

Procesverbalet do të përmbajnë:

1. Emërtimin e zonës dhe numrin e qendrës së votimit.
2. Kohën e fillimit dhe të përfundimit të votimit.
3. Numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve.
4. Numrin e zgjedhësve në listën shtesë.
5. Numrin e votuesve sipas shënimeve në listat e zgjedhësve.
6. Numrin e fletëvotimeve të marra në dorëzim.
7. Numrin e fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara dhe gjatë procesit të votimit.
8. Numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
9. Numrin e fletëvotimeve të gjetura brenda në kuti.
10. Numrin e fletëvotimeve të parregullta.
11. Numrin e fletëvotimeve të rregullta.
12. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të pavlefshme.
13. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të vlefshme për secilin nga kandidatët ose subjektet.
14. Numrin e kopjeve, në të cilat është hartuar procesverbali.
15. Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet e marra për to.

Të dhënat e pikave nga "3" deri në "14" jepen me shifra dhe fjalë.

Procesverbali firmoset nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit dhe duhet të përmbajë vulën përkatëse.

Çdo anëtar i komisionit të qendrës së votimit është i detyruar të firmosë procesverbalet. Ai ka të drejtë të shkruajë në procesverbal të gjitha vërejtjet dhe pranë nënshkrimit të tij të shënojë fjalët "me vërejtje". Në qoftë se njëri nga anëtarët e komisionit nuk pranon të nëshkruajë procesverbalin, atëherë mungesa e nënshkrimit të tij nuk e bën atë pavlefshëm. Ky rregull zbatohet edhe për komisionin e zgjedhjeve të zonës.

Çdo anëtar i komisionit që ka nënshkruar ka të drejtë të marrë kopje të procesverbalit.

Menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve të votimit, komisioni i qendrës së votimit bën afishimin e tyre në një vend të dukshëm jashtë mjedisit të qendrës së votimit."

Neni 36

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë merr këtë përmbajtje:

"Komisioni i qendrës së votimit i dërgon komisionit të zgjedhjeve të komunës ose bashkisë përkatëse 2 kopje të procesverbalit për zgjedhjen e këshillit të rrethit, së bashku me fletët e votimit për këshillin e rrethit. Këto dokumente komisioni i zgjedhjeve të komunës ose bashkisë ia përcjell komisionit të zgjedhjeve të rrethit."

2. Paragrafi i fundit hiqet.

Neni 37

Neni 78 ndryshohet si vijon:

"Komisionet e zgjedhjeve të komunës dhe bashkisë nxjerrin rezultatin e votimit mbi bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe i shpallin ato në formën e një procesverbali për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për kryetarin e komunës ose të bashkisë dhe të një procesverbali për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për këshillin e komunës ose të bashkisë, të cilët duhet të përmbajnë:

1. Emërtimin e zonës dhe numrin e qendrave të votimit.
2. Numrin e zgjedhësve sipas listave të zgjedhësve.
3. Numrin e zgjedhësve në listat shtesë.
4. Numrin e votuesve sipas shënimeve në lista.
5. Numrin e fletëvotimeve të marra në dorëzim nga komisionet e qendrave të votimit.
6. Numrin e fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara dhe gjatë procesit të votimit.
7. Numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
8. Numrin e fletëvotimeve të gjetura brenda në kuti.
9. Numrin e fletëvotimeve të parregullta.
10. Numrin e fletëvotimeve të rregullta.
11. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të pavlefshme.
12. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të vlefshme për secilin nga kandidatët ose subjektet.
13. Numrin e kopjeve, në të cilat është hartuar procesverbali.
14. Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet e marra për to.

15. Emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit që fiton në zgjedhjen për kryetar komune a bashkie; kur duhet të bëhet raund i dytë emrin, atësinë dhe mbiemrin për dy kandidatët e parë; për zgjedhjet për këshillin e komunës ose të bashkisë, emrat e kandidatëve të listave shumemërore të subjekteve elektorale përkatëse që, sipas renditjes së tyre në këto lista, fitojnë vendet në këshill, si dhe kandidatët e pavarur që kanë fituar vende në këshillin e komunës a të bashkisë.

Të dhënat në numrat 2 deri në 13 duhet të bëhen me shifra dhe fjalë.

Menjëherë pas nxjerrjes së rezultateve të votimit, komisioni i zgjedhjeve i komunës ose i bashkisë bën afishimin e tyre në një vend të dukshëm jashtë mjediseve të këtij komisioni.

Neni 38

Neni 79 ndryshohet si vijon:

"Komisioni i zgjedhjeve të rrethit nxjerr rezultatin e zgjedhjeve për këshillin e rrethit mbi bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe e shpall atë në formën e një procesverbali, i cili duhet të përmbajë:

1. Emërtimin e zonës dhe numrin e qendrave të votimit.
2. Numrin e zgjedhësve në listat e zgjedhësve.
3. Numrin e zgjedhësve në listat shtesë.
4. Numrin e votuesve sipas shënimeve në lista.
5. Numrin e fletëvotimeve të marra në dorëzim nga komisionet e qendrave të votimit.
6. Numrin e fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara dhe gjatë procesit të votimit.
7. Numrin e fletëvotimeve të papërdorura.
8. Numrin e fletëvotimeve të gjetura brenda në kuti.
9. Numrin e fletëvotimeve të parregullta.
10. Numrin e fletëvotimeve të rregullta.
11. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të pavlefshme
12. Numrin e fletëvotimeve të rregullta të vlefshme për secilin nga subjektet ose kandidatët e pavarur që marrin pjesë në zgjedhjet për këshillin e rrethit.
13. Numrin e kopjeve në të cilat është hartuar procesverbali.
14. Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve dhe të vëzhguesve të veçantë dhe vendimet e marra për to.
15. Emrat e kandidatëve të listave shumemërore të subjekteve elektorale përkatëse që, sipas renditjes së tyre në këto lista, fitojnë vendet në këshillin e rrethit, si dhe emrat e kandidatëve të pavarur që kanë fituar vende në këtë këshill.

Të dhënat e pikave nga "2" deri në "13" jepen me shifra dhe fjalë.

Menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit të votimit, komisioni i zgjedhjeve i rrethit bën afishimin e tij në një vend të dukshëm jashtë mjediseve të këtij komisioni."

Neni 39

Neni 80 ndryshohet si vijon:

"Numri i vendeve që i takojnë çdo subjekti elektoral caktohet në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ka fituar çdo subjekt. Shpërndarja e tyre bëhet si më poshtë:

a) Gjendet shuma e votave të vlefshme e të gjitha subjekteve elektorale dhe e kandidatëve të pavarur. Numri i votave të vlefshme për secilin kandidat të pavarur pjesëtohet me këtë shumë dhe thyesa që del shumëzohet me numrin e vendeve për këshilltarë të këshillit përkatës. Në rastin kur nga veprimet e mësipërme del një numër i madh ose i barabartë me 1, atëherë kandidatit të pavarur përkatës i jepet vend në këshill.

b) Pastaj numri i votave të vlefshme për secilin subjekt elektoral dhe për secilin nga kandidatët e pavarur që nuk përfitojnë vend nga veprimet e shkronjës "a", pjesëtohet me shumën e përgjithshme të këtyre votave. Thyesat që dalin, shumëzohen me përfundimin që del nga diferenca ndërmjet numrit të vendeve në këshillin përkatës me vendin ose vendet që u janë shpërndarë kandidatëve të pavarur në bazë të shkronjës "a".

c) Çdo listë subjekti merr aq vende në këshill sa numra të plotë i takojnë nga rezultati i veprimeve sipas shkronjës "b". Vendet që mbeten u shpërndahen subjekteve elektorale e kandidatëve të pavarur sipas radhës së madhësisë së numrave pas presjes dhjetore. Në rast se për dy ose më shumë prej tyre numrat pas presjes dhjetore janë të barabartë, atëherë vendi për këshilltar jepet duke përdorur shortin.

ç) Vendet e fituara nga listat e subjekteve u jepen kandidatëve të tyre në bazë të renditjes në listat përkatëse."

Neni 40

Neni 82 ndryshohet si vijon:

"Komisionet e zgjedhjeve të zonave i dërgojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (komisioni i zgjedhjeve i komunës ose bashkisë brenda dy ditëve nga përfundimi i votimit, kurse komisioni i zgjedhjeve i rrethit brenda 3 ditëve nga përfundimi i votimit) një kopje për çdo procesverbal të rezultateve të zgjedhjeve në komuna, bashki dhe rreth. Dorëzimi i tyre bëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari i komisionit të zgjedhjeve të zonës, së bashku me cilindo nga përfaqësuesit e subjekteve elektorale të këtij komisioni që dëshëron. Fletëvotimet, vulat, kutitë e votimit e listat e zgjedhësve dërgohen në prefekturën përkatëse. Fletëvotimet ruhen në prefekturë për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall rezultatet përfundimtare në shkallë kombëtare brenda 5 ditëve pas ardhjes së dokumenteve nga komisionet e zgjedhjeve, të cilat botohen në një buletin të posaçëm."

Neni 41

Neni 84 ndryshohet si vijon:

"Në rastet e mbarimit para afatit të mandatit të këshilltarit, komisioni i mandateve të këshillit lokal shpall të zgjedhur kandidatin e radhës në listën që ka shpallur subjekti përkatës elektoral. Kur në listën e subjektit elektoral nuk ka më kandidatë që mund të zgjidhen në këtë mënyrë, atëherë vendi i këtij këshilltari i kalon subjektit elektoral që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për këshillin përkatës. Në rast barazimi votash përdoret shorti.

Në rastin kur këshilltarit të pavarur i mbaron mandati para afatit, atëherë vendi i tij në këshillin lokal zihet nga kandidati i radhës në listën shumëmemërore të subjektit elektoral që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për këshillin përkatës. Në rast barazimi votash përdoret shorti.

Kur mandati i kryetarit të komunës ose bashkisë mbaron para afatit, atëherë në komunën e bashkinë përkatëse zhvillohen zgjedhje të pjesshme të parakohshme, në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore."

Neni 42

Në nenin 87 shifrat "1.000 deri 5.000" bëhen "10.000 deri 50.000", si dhe shtohet një paragraf

me këtë përmbajtje:

"Bojkotimi i detyrës nga ana e anëtarit të komisionit të zgjedhjeve të çdo niveli në ditën e zgjedhjeve dënohet me heqje lirie nga 1 deri 3 vjet."

Neni 43

Në nenin 88 shifrat "5.000 deri 10.000" bëhen "50.000 deri 100.000".

Neni 44

Ligji nr.7593, datë 29.7.1992 "Për një riformulim të nenit 80 të ligjit nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" dhe ligji nr.7798, datë 23.2.1994 "Për një shtesë në ligjin nr.7573, datë 16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", shfuqizohen.

Dispozitat e ligjit nr.8001, datë 22.9.1995 "Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare", si dhe të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik", të cilat bëjnë fjalë për të zgjedhurit në organet lokale të pushtetit, shfuqizohen përsa i përket kandidatëve dhe të zgjedhurve në këshillat lokale, si dhe kandidatëve dhe të zgjedhurve kryetarë komune.

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi më datë 12.9.1996.

Shpallur me dekretin nr.1600, datë 12.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha